

BESARTA QALLIAJ

**SKAJET GRAMATIKORE SINTAKSORE TË VENDOSURA NË
KOMISINË LETRARE SHQIPE NË SHKODËR**

Studiuesi i njohur i Gramatologjisë shqiptare dhe i Historisë së Albanologjisë, Jup Kastrati, kur merr në analizë një broshurë prej 23 faqesh me titull *“Oroë permii abetare shqyp”*, publikuar më 1899 nga shoqëria “Bashkimi” e Shkodrës, tregon se kjo shoqëri kulturore brenda 9 vjetëve kishte botuar 32 libra, si dhe një fjalor, i cili, *deri me botimin e “Fjalorit” të Institutit të Shkencave* (1954), konsiderohej ndër më të mirët në leksikografinë shqiptare. Pjesa dërmuese e këtyre botimeve të shoqërisë “Bashkimi”, thekson Kastrati, shquhen për një gjuhë të pastër dhe për një terminologji, relativisht të mirë dhe mjaft të njësuar, e cila vazhdoi deri më Komisinë Letrare (1916)¹.

Kjo ngjarje me shumë rëndësi në historinë e planifikimit të shqipes, e cila e zhvilloi veprimtarinë e vet në Shkodër, gjatë tre vjetëve (1916-1918), shënon fillimin a hedhjen e bazave shkencore të përpunimit dhe kodifikimit (normëzimit) të termave në gjuhën shqipe dhe bën hapat e parë të hartimit të terminologjisë në fusha të ndryshme të dijes. Në numrin 1 – Kallënduer 1918, Vjeti I, me titull *“Laimet e Komisis Letrare Shqipe në Shkodër”*², në mbledhjen e 14 frorit 1917, në vendimin nr. 3, formulohet:

“Komisija vendoi, qi hartimi i termave të çdo dege t’u vëhet për barrë atyne misëve, të cilët janë dhanë ma fort me atë degë ditunije e mbasandaj t’i paraqitet nga një listë secilit mas qi t’a studiojë edhe mund t’api mendimin e vet në një mbledhje të përbashkme. Një mbledhje me randsi themelore nga ana e termave teknike u ba me 20 të Frorit 1917 e u gjendën në këtë mbledhje Z.Z. Dr. Pekmezi, S. Peci, L. Gurakuqi, A. Paluca, Dom A. Mjedja, L. Naraçi e A. Xhuvani.

Terminologjia

Vendime, mbi të cilat Komisia letrare do të themelohet në trajtimin e termave (skajeve) teknike:

Komisija letrare është tue pamun për ditë e më tepër nevojën, qi ka gjuha shqype për skaje teknike, të cilat kanë një randsi të madhe për zhvillimin e lavrimit kombtar e për lehtësimin e veprimit të degave të ndryshme

¹ J. Kastrati, *Shoqëria “Bashkimi” e Shkodrës (1899)*. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, *Konferenca e parë e studimeve Albanologjike*, 15 – 21 Nëntor 1962, Tiranë, 1965, f. 227.

² T. Osmani, *Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916 – 1918)*, Shtëpia botuese “Camaj-Pipaj”, Shkodër, 2009, f. 255.

t'Administratës, për këtë arsye pra, tue u mbështetun mbi vendimet e dhanuna në mbledhjet më 14.X.1916 e më 13.II.1917 po caktohen sot këto parime, mbas të cilave do të gjurmojë trajtimin e skajeve të përmenduna.

1) Tue marrë parasysh, se gjuha shqipe mjerisht deri tashti nuk ka qenë e livrueme edhe e punueme nëpër shkolla e administrata si gjuhë e përgjithshme dhe e përbashkme edhe tue qenë, se visari i gjuhës nuk është i përmbledhun, për këtë shkak Komisis i bije për barrë hartimi i një shumicës së madhe të termavet teknike. Duhet pra të ruhet fort si nga neologjizmat si nga barbarizmat e teperme; mbasi nga neologjizmat kuptimi i gjuhës do të bâhet shumë i vështirë; në vend që nga barbarizmat gjuha do të bjerri ngjyren kombtare.

2) Termat e përgjithshëm të ditunis të rrjedhuna prej gjuhvet klasike e që kanë marrë sot një ngjyrë ndërkombtare, tue qenë të pranuese në të gjitha gjuhët e Evropës do të pëlqehen edhe në gjuhën shqype ndën trajtën, që i përket karakterit të gjuhës.

3) Skajet që nuk mund të thirren të përgjithshme, do të përbâhen prej rrajavet shqype a do të përdoren për 'to fjalë të gjalla, të cilavet u duket mirë kuptimi. Atje, ku këjo punë nuk mund të bâhet, do të mund të pranohen edhe terma të hueja, tue marrë para sysh gjuhët e reja, që nuk janë neolatine. Këjo punë po bâhet nga ngushtimi i kohës, edhe nga mungimi i landës, edhe nga shkaku, që është më lehtë të shkulet me kohë nga gjuha një termë e huej, se të ndreqet një termë e bamun keq nga rraja shqype.

4) Disa pak fjalë të hueja a të hapuna edhe të njoftuna nepër gjithë Shqypnin edhe për të cilat nuk ka sot një korrespondentë, do të përdoren përkohësisht, deri sa t'u gjindet apo t'u sajohet korrespondentja shqype.³

Pas këtyre vendimeve, që janë parime të përgjithshme shkencore për hartimin e skajeve teknike (siç quhen me sinonimi), me një fjalorth jepen 362 terma *për gjyqe e administrata*, për të cilat hartuesit (me një asterisk *) vënë edhe shënimin: *Per qortimin e ligjes së gjyqeve të paqit i ra komisis një barrë bukur e randë, don me thanë të gjeturit në gjuhë shqipe të njaj sasije të madhe fjalësh teknike, që u përkthyen prej turqishte. Sigure kanë mujtë me shpëtue lajthime, por koha ka për t' ndrequn.*⁴ Në numrin 2, Kallënduer 1918, Vjeti I, të broshurës.

³ Po aty, f. 255 – 256.

⁴ Po aty, f. 255.

L A I M E T

E

KOMISËS LETRARE SHQIPE

NË SHKODËR

mësojmë se me 2 të Korrikut 1917... u përban edhe një pjesë e termave të gramatikës. Termat e gramatikës, të caktuar prej komisionit, janë këto,⁵ prej të cilave po sjellim këtu vetëm termat që lidhen me sintaksën, shpjeguar nga misërt e Komisionit në latinisht dhe gjermanisht:

Skajet gramatikore

shqymë-a - olisio - Elizion	elipsë, mungesore, e paplotë
klapë-t - parenthesis - Klammern	
pikë-a - punctum - Punkt	
presë-a - virgula - Beistrich	
pikëpresë-a - punctum et virgula - Strichpunkt	
rasë-a - casus - Fall	
emnore-ja - nominatives - Nennfall	
gjinore-ja - genitivus - Wessenfall	
dhanore-ja - dativus - Wenfall	
hjekore-ja - ablativus	rrjedhore
vendore-ja - locativus	kaluar funksionalisht kallëzores
thirre-ja - vokativus	
folje-ja - verbum - Zeitwort	
folje ndihse - verbum auxiliarium - Hilfszeitwort	
veprore - verbum activum - Tätigkeitswort	
pësore - verbum passivum - leidendo Form des Zeitwortes	
kaptore - verbum transitivum - intransitives Zeitwort	kalimtare
paravumje - propositio - Satz	fjalë
ndërfjalësi -i - subjectum - Satzgegenstand	kryefjalë
kallxojë-a - praedicatum - Satzaussage	kallëzues
ndajshim-i - attributum - Beifügung	
thirrme-a - interjectio - Ausrufewort	thirr
përkryes-i - complementum - Ergänzung	plotës *

Mjaft prej këtyre termave kanë pasur jetë të gjatë në gramatikat e tekstet tona shkollore deri në ditët e sotme, me gjithë kundërshtimet e disa prej

⁵ Po aty, f. 292.

intelektualëve të kohës, si për shembull, të poetit e folkloristit Vinçenc Prendushit, sidomos me shkrime e artikuj të botuar në gazetën e kohës që dilte në Shkodër, “Posta e Shqypniës”, bash në vitet kur vepronte Komisia Letrare e Shkodrës (1916 – 1918)⁶. Koherent në përdorimin e këtyre termave (duke krijuar edhe vetë ai të tjera), është treguar Aleksandër Xhuvani, i cili, që në vitin 1919, kur hartoi tekstin:

**Botim i Drejtoris’së përgjithëshme t’Arsimit
No. 22**

**LIBRI I GJUHËS SHQIPE
PËR
KLASËN E TRETË TË FILLORES
PREJ
A. XHUVANIT**

Shpallje e tretë e shtuese edhe e përmirësuese

TIRANË

Shtypur në shtyp. “Mbrothësia” Kristo P. Luarasi
1926

shprehet: “Në punë t’orthografis e të skajeve gramatikore e pashë me udhë, qi t’i ruej si skajet, si rregullat ortografike qi themeloi Komisia letrare e Shkodrës: po në qoftë se diku kam dalë jashtë këtyneve, faji asht i shtypshkrojës, e cila nga mungesa e shkrojavet nuk mundi me i u-përgjegjë krejt shkrimit të drejtë t’atyne rregullave.”⁷

⁶ T. Topalli, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Buletin shkencor, “Maksimilian Lamerci dhe gazeta “Posta e Shqypniës”, nr. 59, 2009, f. 12.

⁷ A. Xhuvani, *Libri i gjuhës shqipe për klasën e tretë të fillores*, Tiranë, 1926, f. 5 (Parathania, N’Elbasan, mbë 13 të Prillit 1919).